



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
KRYETARI

Adresa: Rruga "Abdi Toptani" Nr.1

Tiranë E-mail: klsh.org.al; site [.klsh.org.al](http://klsh.org.al)

Nr. 262/___Prot.

Tiranë, më **27.06.2020**

V E N D I M

Nr. 75, Datë 27.06.2020

PËR
AUDITIMIN E USHTRUAR NË BASHKINË URA VAJGURORE "MBI AUDITIMIN
FINANCIAR DHE TË PËRPUTHSHMËRISË"
PËR PERIUDHËN 01.01.2017 - 31.03.2020.

Në auditimin e ushtruar në Bashkinë Ura Vajgurore, me objekt "Mbi auditimin financiar dhe të përputhshmërisë" për periudhën 01.01.2017 - 31.03.2020, mbi shkallën e zbatueshmërisë nga subjekti të rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, u konstatuan të meta dhe mangësi në funksionimin e disa komponentëve të sistemit të kontrollit të brendshëm, devijime/shkelje nga kuadri ligjor dhe rregulator në fuqi, efektet e të cilave justifikojnë dhënien e një opinionit financiar të kualifikuar dhe për përputhshmërinë opinion i modifikuar me rezervë.

Pasi u njoha me Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe Projektvendimin e paraqitur nga Grupi i Auditimit të Departamentit të Auditimit të Vetëqeverisjes Vendore, shpjegimet dhe komentet e dhëna nga subjekti i audituar, si dhe vlerësimet mbi objektivitetin dhe cilësinë e auditimit nga Kryeaudituesit e Departamentit të mësipërm, Drejtori i Drejtorisë së Standardeve dhe Sigurimit të Cilësisë së Auditimit, si dhe Drejtori i Përgjithshëm, në mbështetje të neneve 10, 15, 25 dhe 30, të ligjit nr. 154/2014 miratuar në datën 27.11.2014 "Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", me qëllim përmirësimin e gjendjes.

VENDOSA:

I. Të miratoj Raportin Përfundimtar të Auditimit në Bashkinë Ura Vajgurore, sipas programit të auditimit nr. 262/1 prot., datë 02.03.2020, ndryshuar me shkresat nr.262/2 prot., datë 24.04.2020, dhe 262/3 prot., datë 19.05.2020, të miratuar nga Kryetari i KLSH, për periudhën 01.01.2017-31.03.2020.

II. Të miratoj Opinionin e auditimit, rekomandimet për përmirësimin e gjendjes dhe të kërkoj marrjen e masave sa vijon:

A. OPINIONI I AUDITIMIT.

I. Opinioni i auditimit mbi pasqyrat financiare.

Për drejtimin e Bashkisë Ura Vajgurore.

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Bashkisë Ura Vajgurore për vitin ushtrimor 2019, të cilat përfshijnë pasqyrat e pozicionit financiar, pasqyrat e performancës, pasqyrat e ndryshimeve në kapital, pasqyrat e fluksit të mjeteve monetare dhe shënimet shpjeguese që shoqërojnë këto pasqyra.

Auditimi ka përfshirë ekzaminimin, në bazë testimesh, të dokumenteve që mbështesin shumat dhe shpalosjet në pasqyrat financiare, ku u bë vlerësimi i parimeve kontabël të përdorura dhe vlerësimeve të bëra nga drejtuesit, si dhe vlerësimi i paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare.

Opinioni i kualifikuar¹ për pasqyrat financiare të vitit 2018 dhe 2019:

Sipas mendimit tonë, pasi kemi marrë dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit, mbështetur në standardet ISSAI 1700 dhe ISSAI 1200 shprehim një opinion të kualifikuar për llogaritë vjetore të Bashkisë Ura Vajgurore, duke arritur në përfundimin se anomalitë apo rastet e mospërputhshmërisë, individualisht ose së bashku, janë materiale, por jo të përhapura, në periudhën nën auditim dhe mbi të gjitha, janë të korigjueshme. Në opinionin tim, Pasqyrat Financiare të Bashkisë Ura Vajgurore, përveç çështjeve të trajtuara në bazën për kualifikimin e opinionit, paraqesin drejt, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar në 31 Dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2019, performancën e saj financiare dhe fluksin e parasë për vitet respektive në përputhje me Kuadrin e Raportimit Financiar të Sektorit Publik.

Baza për opinionin e Kualifikuar:

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen Përgjegjësitë e Audituesit për Pasqyrat Financiare. Ne jemi të pavarur nga subjekti i audituar në përputhje me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë. (ISA 705-ISSAI 1705)

Ne i tërheqim vëmendjen subjektit të audituar për çështjet e theksuara më poshtë, të cilat nuk janë thelbësore dhe me ndikim në pasqyrat financiare; Për këto arsye kemi dhënë opinion të pamodifikuar/pakualifikuar me theksim çështjeje, sipas shpjegimeve në Raportin përfundimtar të auditimit.

Përgjegjësitë e Drejtuesve të Bashkisë Ura Vajgurore.

Strukturat drejtuese të subjektit Bashkia Ura Vajgurore, janë përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e saktë të pasqyrave financiare në përputhje me kërkesat e ligjit “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” dhe kërkesat e tjera në kuadrin e raportimit financiar në fuqi, si dhe funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm që ka rezultuar i nevojshëm për përgatitjen e pasqyrave financiare, për të shmangur gabimet apo mashtrimet. Stafi drejtues është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me politikat, ligjet dhe rregulloret e aplikuar në procedurat be prokurimit. Personat përgjegjës për drejtimin janë përgjegjës për kontrollin e procesit të raportimit financiar. Stafi drejtues është përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me të gjitha ligjet dhe rregulloret në fuqi.

¹ Një opinion i kualifikuar (i modifikuar) jepet kur audituesi ka marrë dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit dhe arrin në përfundimin se anomalitë apo rastet e mospërputhshmërisë, individualisht ose së bashku, janë materiale, por jo të përhapura, në llogaritë vjetore apo transaksionet në fjalë ose kur audituesi nuk është në gjendje për të marrë dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit ku të bazojë opinionin, dhe efektet e mundshme mbi llogaritë vjetore apo transaksionet të kësaj pamundësie janë materiale por jo të përhapura. Kur gabimet janë materiale por jo të përhapura, audituesi paraqet një opinion të kualifikuar.

Përgjegjësitë e Audituesve të KLSH mbi Auditimin e Pasqyrave Financiare

Objektivi i audituesit të jashtëm publik lidhet me garantimin e sigurisë së arsyeshme nëse pasqyrat financiare në tërësi, nuk paraqesin anomali materiale, kështu si pasaktësi apo gabime që mund të kenë ekzistuar, si dhe për të konkluduar me një raport auditimi që përfshin një opinion. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë. Përveç standardeve ISSAI, audituesi i KLSH, gjithashtu aplikon edhe gjykimin dhe skepticizmin tonë profesional në punën audituese.

Auditimi identifikon çështjet më të rëndësishme lidhur me auditimin e pasqyrave financiare të periudhës aktuale dhe i përshkruajmë ato në raportet e auditimit, me përjashtim të rasteve kur kuadri ligjor nuk lejon vënien në dispozicion të tyre për publikun ose në raste të rralla kur vetë ne vendosim që këto çështje nuk duhet të përfshihen në raport për shkak të pasojave negative që publikimi i tyre mund të sjellë në publikun e gjerë.

Ne i kemi përmbushur përgjegjësitë tona etike, në përputhje me standardet e sipërpërmendura. Gjithashtu, ne besojmë se dëshmitë e marra gjatë punës sonë audituese janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazat për përgatitjen e opinionit të auditimit.

II- Opinion mbi përputhshmërinë.

Për drejtimin e Bashkisë Ura Vajgurore.

Ne kemi audituar përputhshmërinë² e subjektit përsa i takon shkallës së zbatueshmërisë të rregullave, ligjeve, termave dhe kushteve, mbi të cilat është rënë dakord (kriteret e auditimit të përputhshmërisë), në kryerjen e procedurave të prokurimit publik.

Auditimi ka përfshirë:

- ekzaminimin e zbatimit të procedurave të prokurimit në masën 97.4% të fondit limit, në bazë testimesh, bazuar në dokumentacionin mbi procedurat e prokurimit të ndodhura në dosjet përkatëse, si dhe dokumentacionin e ngarkuar në SPE, për vitet 2017 -2019;
- ekzaminimin e dokumentacionit të zbatimit të kontratave për punë civile në 8 raste për vitet 2017 – 2019;
- Zbatimin e buxhetit dhe të ardhurat;
- Menaxhimin financiar dhe kontrollin

Opinion i modifikuar me rezervë³.

Sipas mendimit tonë, përveç efekteve të çështjeve të përshkruara në paragrafin e “Bazës për opinionin me rezervë”, procedurat e prokurimit të zhvilluara gjatë vitit ushtrimor 2017, 2018, 2019 në 19 raste nuk janë kryer në përputhje me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” me ndryshime, VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” me ndryshime, dokumentet standarde të tenderit (DST), si dhe akte të tjera nënligjore, mbi të cilat subjekti i audituar është mbështetur për kryerjen e procedurave dhe që kanë shërbyer si kritere vlerësimi.

Baza për opinion me rezervë:

Opinionin e dhënë e mbështesim në faktin se; u konstatuan devijime të cilat në gjykimin profesional të audituesit të pavarur janë materiale, por jo të përhapura, konkretisht:

- Në administrimin e shpenzimeve operative, nuk është arritur eficaenca dhe efikasiteti i procedurave të prokurimit, duke mos përmbushur kështu, qëllimin e ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, veprime me paligjshmëri të përdorimit të fondeve publike në fushën e prokurimit në vlerën **344,972 mijë lekë**, etj.

² Mbështetur mbi Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e KLSH-së”.

³ Manuali i Auditimit të Përputhshmërisë; Kapitulli V “Raportimi i auditimit”, pika 5.4 “Konkluzionet/opinionin në auditimin e përputhshmërisë”; INTOSAI/2019 “framework of Professional Pronouncements” (IFPP), ISSAI 400 “Parimet e Auditimit të Përputhshmërisë” dhe ISSAI 4000 “Standardet e auditimit të përputhshmërisë”, Kapitulli 9 “Raportimi”.

Për këto u analizuan 38 procedura prokurimi me vlerë të fondit limit 625,492 mijë lekë ose 97.4 % të fondit limit të prokuruar për periudhën 01.01.2017 – 31.12.2019.

- Në fushën e zbatimit të kontratave për punë civile, shërbime e mallra si dhe mungesës së lidhjes së kontratave me subjektet e shfrytëzimit të guroreve, janë konstatuar parregullsi për vlerën e dëmit ekonomik prej **42,161 mijë lekë**, si rezultat i mos përfundim në afat të punimeve dhe mangësive të konstatuara në zbatimin e punimeve jo sipas projekt preventivin të punimeve.

- Në administrimin e të ardhurave vendore nga subjektet fizik/juridik dhe abonentët familjare, nuk është ndjekur e plotë procedura në zbatim të dispozitave të ligjit nr. 9920, datë 28.5.2008 “Për Procedurat tatimore në RSH”, i ndryshuar, ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, me ndryshime dhe Vendimeve respektive të Këshillit Bashkiak, për arkëtimin e vlerës **223,115 mijë lekë**, si e ardhur e munguar në buxhetin e Bashkisë Ura Vajgurore. Borxhi tatimor i konstatuar është në vlerën **23,615 mijë lekë**.

- Detyrimet për 6 vendime gjyqësore janë në vlerën **18,652 mijë lekë** (nga të cilat 5 për largime nga puna dhe një penalitet).

- Mos zbatimi i rekomandimeve nga auditimet e kaluara, duke vlerësuar se nuk është marrë asnjë masë për zbatimin e tyre, kryesisht për vlerën e shpërblimit të dëmit prej **6,671 mijë lekë**.

Përgjegjësitë e Drejtuesve të Bashkisë Ura Vajgurore:

Strukturat drejtuese të Bashkisë Ura Vajgurore, janë përgjegjëse për zhvillimin e procedurave të prokurimit publik në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore të fushës, me qëllim rritjen e pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë, minimizimin e kostove dhe shmangien e gabimeve apo mashtrimeve. Stafi drejtues, është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me politikën, ligjet dhe rregulloret e aplikuara (kriteret e vlerësimit). Stafi drejtues është përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me të gjitha ligjet dhe rregulloret në fuqi.

Përgjegjësitë e Audituesve të KLSH mbi Auditimin e Përputhshmërisë:

Objekti i audituesit të jashtëm publik lidhet me garantimin e sigurisë së arsyeshme, nëse procedurat e prokurimit publik të zhvilluara nga Autoriteti Kontraktor “Bashkia Ura Vajgurore”, nuk paraqesin anomali materiale, kështu si pasaktësi apo gabime që mund të kenë ekzistuar, nëse procedurat e prokurimit publik janë zhvilluar në përputhje me kriteret e paracaktuara, si dhe për të konkluduar me një raport auditimi që përfshin një opinion mbi përputhshmërinë. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë. Përveç standardeve ISSAI, audituesi i KLSH, gjithashtu aplikon edhe gjykimin dhe skepticizmin e tij profesional në punën audituese.

Auditimi identifikon çështjet më të rëndësishme lidhur me auditimin e procedurave të prokurimit publik të periudhës objekt auditimi, duke i përshkruar në raportin e auditimit, me përjashtim të rasteve kur kuadri ligjor nuk lejon vënien në dispozicion të tyre për publikun ose në raste të rralla kur vetë ne vendosim që këto çështje nuk duhet të përfshihen në raport për shkak të pasojave negative që publikimi i tyre mund të sjellë në publikun e gjerë.

B. MASAT ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi: Për të vlerësuar funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm dhe zbatimin e kërkesave të ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, grupi i auditimit testoi *komponentët vlerësues të funksionimit të kontrollit të brendshëm*, nga të cilat rezultoi;

-Mjedisi i kontrollit. Strukturat e Bashkisë, funksionojnë sipas detyrave të përcaktuara në rregulloren e brendshme të miratuar me urdhër të Kryetarit të Bashkisë, por nuk është miratuar kodi i etikës profesionale.

Nga ana e Titullarit të Bashkisë, nuk janë nxjerrë urdhra me shkrim për mënyrën e ushtrimit të veprimtarisë së kontrollit. Nuk janë miratuar gjurmët e auditimit. Lëvizjet e punonjësve për shkak të ndërprerjes së marrëdhënieve të punës, vlerësohet me risk përse i përket shkallës së kualifikimit të tyre, veprime në kundërshtim me UMF nr. 2, datë 6.02.2012 “Për procedurat standard të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar, pika 40 dhe ligjit nr. 10296, datë 8.07.2010, neni 4 pika 19, neni 16 pika 2 dhe neni 22.

-Menaxhimi i riskut. Lidhur me identifikimin e aktiviteteve më risk, hapjen e regjistrit të riskut si dhe menaxhimin e tij, është caktuar koordinatori i riskut në kundërshtim me kërkesat e nenin 21 të ligjit nr. 10296, datë 8.07.2010.

Nuk është miratuar strategjia e menaxhimit të riskut, nuk janë identifikuar aktivitete me risk, si dhe nuk janë marrë masa për menaxhimin e tij.

-Veprimtaritë e kontrollit. Në këtë Bashki, është krijuar Grupi i Menaxhimit Strategjik (GMS), por nuk janë miratuar Planet e Zhvillimit Strategjik dhe planet buxhetore afat mesëm, në kundërshtim me nenin 27, të ligjit nr. 10296, datë 8.07.2010; ligjit nr. 68-2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, neni 32 dhe UMF nr. 8 dt. 29.3.2012 “Procedura e përgatitjes të Buxhetit afatmesëm”, Kap. V.

-Informacioni dhe komunikimi. Realizohet sipas shkallës së strukturave, bazuar edhe në rregulloren e funksionimit të brendshëm, në zbatim të kërkesave të nenin 23 të ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010.

-Monitorimi. Në monitorimi i sistemit të menaxhimit financiar dhe të kontrollit, u konstatuan se nuk janë përmbushur kërkesat ligjore, konkretisht janë konstatuar raste ku marrja në dorëzim e punimeve të kontraktuara ose furnizimi me materiale sipas kontratave, nuk janë bërë me komisione të ngritura për këtë qëllim. Këto raste janë shkëlqje e kërkesave të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar Kap. III, pikat 42, 47 (*Më hollësisht trajtuar në pikën (IV/A.1), faqe 12-13 të Raport Auditimit*).

1.1 Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë, të analizojë shkaqet e mos funksionimit të aktivitetit të GMS-së, duke nxjerrë përgjegjësitë më qëllim që GMS-ja të kryejë funksionet e veta ligjore.

1.2 Rekomandimi: Bashkia Ura Vajgurore, të marrë masa për përmirësimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, të hartojë regjistrin e riskut e në mënyrë periodik, si dhe të hartohet rregullore për kodin e etikës përfshirë hartimin e gjurmës së auditimit për proceset kryesore të punës.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i veprimtarisë së Njesisë së Auditit të Brendshëm rezultoi se: nuk është bërë i mundur realizimi i kontroleve për verifikimin e detyrave të lënë nga misionet e auditimit të kryera, pikë e cila nuk rezulton të jetë dhe në programet e auditimit të subjekteve të ri kontrolluara, duke bërë që si nga NJAB ashtu dhe Menaxheri i Njesisë të mos informohet mbi nivelin e zbatimit të rekomandimeve të lëna nga auditimet e kryera, në kundërshtim me ligji nr. 114/2015, datë 22.10.2015 “Për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik”; VKM nr. 83, datë 03.02.2016 “Për miratimin e kritereve të krijimit të Njësive të Auditimit të Brendshëm në sektorin publik”; Urdhrit të Ministrit të Financave nr. 100 datë 25.10.2016 “Për Miratimin e Manualit të Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik”;

(trajtuar me hollësisht në faqe 13 -14 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

2.1 Rekomandimi: Drejtoria e Auditit të Brendshëm, në përfundim të procesit të auditimit në njësitë e audituara, të kryejë monitorimin e zbatimit rekomandimeve i cili kërkon që në zbatim rekomandimeve, Drejtuesi i Auditimit Brendshëm duhet të vendosë dhe të mirëmbajë një sistem

për monitorimin e trajtimit të rezultateve të komunikuar menaxhimit sipas Manualit Auditit të Brendshëm.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

3. Gjetje nga auditimi: Nga verifikimi i dokumentacionit për zbatimin e rekomandimeve të dhëna në auditimin e mëparshëm në mënyrë të përmbledhur rezulton si më poshtë:

a. Me shkresën nr. 259/19, datë 06/07/2017, nga ana e KLSH janë rekomanduar 20 masa organizative nga të cilat janë zbatuar 17 masa, janë në proces zbatimi 3 masa dhe nuk është zbatuar 1 masë ajo me nr. 20 për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH në vitin 2014.

b. Janë rekomanduar 9 masa për shpërblim dëmi nga të cilat për 6 masa (masa nr. 1, 2, 3, 4, 5, 6) në shumën 6,619,712 lekë subjekti është në procese gjyqësore.

c. Janë rekomanduar APP masa administrative për 11 raste, me shkresën nr. 259/29, datë 07.12.2017 sipas Vendimit nr. 88, datë 05.12.2017 të APP për 1 masë disiplinore dhe 9 masa me gjobë në shumën 680,000 lekë të cilat ri kërkohen për zbatim.

d. Masa administrative në bazë të Vendimit të APP nr. 88, datë 05.12.2017 në shumën 680,000 lekë.

Veprimet e mësipërme janë në shkelje të nenit 15, shkronja (j) dhe nenit 30 pika 2, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollin të Lartë të Shtetit” (trajtuar me hollësisht në faqe 14 -16 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

3.1 Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Ura Vajgurore të marrë masa dhe të analizojnë në Bashki dhe Këshillin Bashkiak, mos zbatimin e plotë të rekomandimeve të dërguara nga KLSH me shkresën nr.259/19, datë 06/07/2017 “Për zbatimin e Rekomandimeve nga auditimi i kryer në Bashkinë Ura Vajgurore”, duke nxjerrë përgjegjësitë e personave përgjegjës, si dhe të hartojë plan pune të veçantë e të marrë të gjitha masat e duhura ligjore për ri zbatimin e plotë të tyre, respektivisht:

-3 masa organizative të cilat janë në proces zbatimi.

-9 masa për shpërblim dëmi në shumën 6,670,752 lekë nga të cilat për 6 masa (masa nr. 1, 2, 3, 4, 5, 6) në shumën 6,619,712 lekë subjekti është në procese gjyqësore dhe 1 është në proces.

- Masa administrative të rekomanduara APP, për 11 raste, e cila me shkresën nr. 259/29, datë 07.12.2017 sipas Vendimit nr. 88, datë 05.12.2017 ka dhënë 1 masë disiplinore dhe 9 masa me gjobë në shumën 680,000 lekë.

Menjëherë dhe në vijimësi

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i programimit, aprovimit, realizimit dhe monitorimit të buxhetit për vitet 2017, 2018 dhe 2019, u konstatua se:

Buxheti për vitin 2017 - 2019 paraqitet me një performancë jo të kënaqshme në lidhje me detyrimet e papaguara, të cilat janë në nivel të lartë, ku vlera totale e detyrimeve të mbartura në vitin 2017 është në shumën 237,447,614 lekë, për vitin 2018 – 258,661,743 lekë dhe në vitin 2019 në shumën 190,564,044 lekë

Në lidhje me detyrimet e pashlyera (467) vlera e detyrimeve të pashlyera është: viti 2017 në shumën 179,212,543 lekë, viti 2018 në shumën 234,762,573 lekë dhe viti 2019 në shumën 173,548, 411 lekë. Ndërkohë të ardhurat për vitin 2017 janë realizuar në masën 50%, për vitin 2018 në masën 62% dhe për vitin 2019 – 53.7%, tregues që tregojnë për një planifikim të të ardhurave mbi një bazë jo reale. Fondet buxhetore të këtyre viteve paraqiten me nivel realizimi për vitin 2017 në masën 87 % dhe për vitin 2018 në masën 86% dhe për vitin 2019 në masën 82.9%. Në këtë nivel realizimi ka ndikuar realizimi në nivel më të ulët i shpenzimeve operative për vitin 2017 në masën 67%, për vitin 2018 në masën 73%, dhe 2019 në masën 63.7%. Po kështu dhe investimet për vitin 2017 në masën 85%, për vitin 2018 në masën 73% dhe 2019 në masën 82.9%. (trajtuar me hollësisht në faqe 16 -21 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

4.1 Rekomandimi:

a-Me qëllim që të mos krijohen diferenca të theksuara ndërmjet programimit dhe realizimit të treguesve të buxhetit, njësia publike Bashkia Ura Vajguore të marrë masa për hartimin sa më real të treguesve të buxhetimit, mbështetur në realizimin e mundshëm e objektiv të të ardhurave. Njëkohësisht në çdo periudhë buxhetore të hartohet (PBA) dhe buxhetit vjetor të ndjek parashikimin e vitit të parë të PBA.

b-Titullari i njësisë vendore dhe Sektori i Zhvillimit Ekonomik dhe Menaxhimit Financiar, të marrë masa të plota për pagesën e faturave të pa likuiduara në vlerën totale 190,564,044 lekë, dhe të paraqesë në mbledhjen e Këshillit Bashkisë, informacion për gjendjen e faturave të pa likuiduara dhe të mbartura dhe të hartojë grafik për shlyerje të tyre.

Menjëherë dhe në vijimësi

5.Gjetje nga auditimi: Bashkia Ura Vajguore, për vitin 2019 ka 5 raste detyrime përmbartimore për detyrim pagesë për largim nga puna me vlerë **3,311,948** dhe në 1 rast për pagesë të vonuar për një kompani, kamat vonesa me vlerë **16,640,021** lekë. Në vitin 2019 janë likuiduar **1,300,000** lekë për detyrime përmbartimore për pagesë për largim nga puna. Në datë 31.12.2019 detyrimi për vendime gjyqësore është në vlerën **18,651,969** lekë. Për këto procese gjyqësore të humbura, Bashkia Ura Vajguore nuk ka analizuar shkaqet e lindjes së tyre dhe nuk ka marrë masa ndaj personave përgjegjës. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr.2, datë 06.02. 2012 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, pika 62 dhe 102, me Udhëzimin nr.2, datë 09.01.2015, “Vendimet gjyqësore” pika 6.1, ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, të ndryshuar neni 12 pikën 3.

(trajtuar me hollësisht në faqe 16 -21 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

5.1 Rekomandimi: Bashkia Ura Vajguore, të nxjerrë përgjegjësitë ligjore e administrative ndaj personave shkaktarë të cilët kanë krijuar detyrimin prej **18,651,969 lekë** për 6 vendimet gjyqësore çka ka ndikuar negativisht në buxhetin e shtetit si dhe të marrë masa për planifikimin e fondeve për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore.

Menjëherë

6. Gjetje nga auditimi: Në Bashkinë Ura Vajguore ushtrojnë aktivitetet për shfrytëzimin e sipërfaqeve pyjore/kullosore 17 subjekte për sipërfaqe 35 ha, është lidhur 1 kontratë qiraje për sipërfaqe 16.2 ha. Për këto sipërfaqe nga Sektori i Pyjeve dhe Mbrojtjes Mjedisit, nuk janë zbatuar procedurat e pakësimit të sipërfaqes së fondit pyjor/kullosor, siç përcaktohet në nenin 17, të ligjit nr. 9385, datë 04.05.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, i ndryshuar, pika 6 e nenit 17, të ligjit nr. 9693 datë 19.03.2007 “Për Fondin kullosor”, pikat 3, 7, 9,10,11 dhe 12, të VKM nr. 1353, datë 10.10.2008 “Për rregullat për paraqitjen e kërkesës, mbajtjen dhe plotësimin e dokumentacionit teknik, kriteret dhe procedurat e zvogëlimit të sipërfaqes dhe të vëllimit të fondit pyjor”, i ndryshuar me VKM nr. 435, datë 08.06.2015, si dhe pikat 3, 6, 7, 9 dhe 11, të VKM nr. 1354, datë 10.10. 2008 “Për rregullat dhe procedurat që ndiqen për heqjen, shtimin dhe ndryshimin e destinacionit të fondit kullosor” (trajtuar me hollësisht në faqe 21 -37 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

6.1 Rekomandimi: Sektori i pyjeve dhe mbrojtjes mjedisit në Bashkinë Ura Vajguore, t'i kërkojë Ministrisë Mjedisit, që të marrë masa për evidentimin e sipërfaqeve të shfrytëzueshme nga subjektet private, duke zbritur nga fondi pyjor dhe kullosor këto sipërfaqe, si dhe të hartojë bilancin e përgjithshëm të sipërfaqeve pyjore dhe kullosore të mbetura. Për rastet kur nuk është vepruar për zbritjen nga fondi pyjor, t'i kërkohet Agjencisë Kombëtare të Hidrokarbureve (AKBN), bllokimi i veprimtarisë së kompanive minerare, deri në zbritjen nga ky fond të sipërfaqeve të shfrytëzueshme

Menjëherë

7. Gjetje nga auditimi: Nga verifikimi i disa artikujve dhe rakordimi me magazinën, u konstatuan probleme me marrjen në dorëzim të mallrave të blera, konkretisht për artikujt që përdoren në ndërtim, si p.sh. çimento, hekur, stabilizant, çakëll, granil, etj., nuk është zhvilluar në rregull procedura për pagesat, marrjen në dorëzim dhe magazinimin e këtyre artikujve, në kundërshtim me UMF nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, ” kap III “Regjistri i aktiveve dhe dokumentimi i lëvizjes së tyre” pikat 34 deri 44. Nga verifikimi i fletë hyrjeve dhe fletë daljeve, u konstatua se procesverbalet e marrjes në dorëzim janë bërë në mënyrë fiktive, pasi fletët e hyrjes mbajnë data duke filluar nga 04.07.2017, deri në 29.12.2017. Ndërkohë, pavarësisht mënyrës së hartimit të procesverbaleve, fletë hyrjet korrespondojnë me fletë daljet, si në sasi edhe në kohë. E njëjta procedurë ka ndodhur për të tre vitet e audituara, për artikuj të ndryshëm, kryesisht në lidhje me ndërtimin.

7/1 Rekomandim: Nga Bashkia Ura Vajgurore, të merren masa nga Nëpunësi Autorizues i cili duhet të përcaktojë kushtet e duhura kontraktuale, ku të mundësohet ruajtja e mallrave të blera në ambientet e furnitorit dhe lëvrimi i tyre sipas nevojës së institucionit, njëkohësisht duke bërë pagesën në momentin e lëvrimin të mallrave, si dhe të marrë masa për të zgjeruar ambientet e magazinimit të mallrave, përfshirë edhe kushtet e magazinimit. Nga Bashkia Ura Vajgurore të merren masa për të përcaktuar kushtet e lëvrimin të mallit, magazinimin e tij dhe në rastet e blerjes së mallrave të bëjë pagesën sipas sasive që nevojiten dhe kur nevojiten.

Në vijimësi

8. Gjetje nga auditimi: Në lidhje me konsumin e karburantit dhe vlerësimin e kontabilizimin e mirëmbajtjes së aktiveve:

1. Nuk disponohej një plan shpërndarjeje, për çdo mjet transporti, makineri apo kaldajë, në kundërshtim me kërkesat e UMF nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” kap III “Regjistri i aktiveve dhe dokumentimi i lëvizjes së tyre”, pika 38 dhe 59.

2. Në asnjë rast nuk ishte kryer rakordimi i fletudhëtimeve me leximin e kilometrazhit apo orëve të punës të çdo mjeti.

3. Nuk disponohej në të gjitha rastet autorizimi, i shoqëruar me një program pune të miratuar nga titullari i institucionit, për lëvizjet e punonjësve apo makinerive, sipas kërkesave të Ligjit nr. 10160 datë 15.10.2009 “Për rregullimin e shërbimit të transportit për funksionarët publikë dhe Nëpunësit civilë”, neni 2 “Kategoritë e përfutuesve”, pika 5.

(trajtuar me hollësisht në faqe 37 -53 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

8/1 Rekomandim: Titullari i Bashkisë Ura Vajgurore të marrë masa, që në çdo rast, automjetet dhe makineritë e institucionit të lëvizin për shërbime vetëm me autorizim apo urdhër të tij, sipas një programi të miratuar prej tij.

8/2 Rekomandim: Nëpunësi Zbatues të marrë masa për të rakorduar furnizimet e mallrave me pagesat, për të rakorduar çdo muaj konsumin e karburantit në fletët e udhëtimit me leximet e kilometrave të përshkuara nga automjetet apo orëve të punës së makinerive/pajisjeve.

Menjëherë

9. Gjetje nga auditimi: Shpenzimet e kryera për mirëmbajtjen e aktiveve (kanaleve ujitëse, kulluese, etj.), nuk ishin shtuar në vlerën historike të aktivitetit përkatës.

9/1 Rekomandim: Nga Nëpunësi Zbatues të merren masa për të inventarizuar, kontabilizuar dhe pasqyruar saktë vlerat e kostos historike të aseteve, duke llogaritur plotësisht shpenzimet e bëra për mirëmbajtjen, rikonstruksionin apo modifikimet/ndryshimet e tyre.

Në vijimësi

10. Gjetje nga auditimi Për vitin 2019, në llogarinë 4342 ka një diferencë/mangësi prej 4,995,915 lekësh, (referuar Tabelës PF13), e cila duke pasur parasysh se Llogaria 4342 është llogari rregulluese, tregon se në hartimin e bilancit e vitit 2019 nuk janë marrë në konsideratë përcaktimet e UMF nr. 8, datë 09.03.2018.

Llogaria 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme” duhet të ketë kundër parti llogarinë 467 “Kreditorë të ndryshëm” dhe të evidentohen veçmas në pasqyrat financiare vjetore dhe zërin e

detyrimeve të prapambetura të tyre ndaj të tretëve, për shpenzime, shërbime apo investime të kryera e të pa financuara, për shkak të mungesës së fondeve. Pra edhe faturat e gjendura nga data baza e thesarit për faturat e vitit 2018, të cilat janë likuiduar në vitin 2019, apo të vitit 2017, të cilat janë likuiduar në vitin 2018 ose nuk janë likuiduar ende, janë fatura që, për shkak të mungesës së fondeve, nuk janë likuiduar si dhe nuk janë paraqitur si detyrime në llogarinë kreditore 467 “Kreditorë të ndryshëm” dhe për të njëjtën arsye, nuk e gjejmë as në llogarinë debitore 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme”. Pra automatikisht kemi një nënvlerësim të llogarisë 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme”.

10/1 Rekomandim: Nga Bashkia Ura Vajguore, të merren masa nga Nëpunësi Zbatues për të rakorduar llogarinë 4342 me llogaritë përkatëse të pasivit dhe për të regjistruar kontratat e lidhura në llogarinë 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme”.

Në vijimësi

11. Gjetje nga auditimi: Vlera historike totale e llogarisë 202 “Studime dhe kërkime” në fund të vitit 2017 ka qenë 19,658,672 lekë, në fund të vitit 2018 ka qenë 28,097,072 lekë dhe në fund të vitit 2019 ka qenë 36,521,816 lekë. Sa më sipër, konkludohet se për këto asete njëzia publike nuk ka përllogaritur dhe kontabilizuar siç duhet normat e amortizimit sipas VKM-së nr. 401, datë 23.10.1989 dhe Kreut III, pika 3.7.2 “Normat e amortizimit sipas grupeve”, të UMF-së nr. 5, datë 30.01.2016 “Për tatimin mbi të ardhurat” i ndryshuar, që përcakton se aktivet e patrupëzuara amortizohen me normën vjetore të amortizimit prej 15 % në vit dhe SKK 5 “Aktivet Afatgjata Materiale dhe Aktivet Afatgjata Jomateriale”. Në këto aktive nuk mund të amortizohen shpenzimet e projektimit, ndërkohë që objekti nuk ka filluar të ndërtohet, përfshirja në shpenzime në këtë periudhë nëpërmjet amortizimit është e gabuar.

Pavarësisht se një pjesë e projekteve dhe studimeve janë vënë në zbatim ose kanë përfunduar gjatë viteve të mëparshme dhe gjatë vitit ushtrimor 2019, nuk i janë shtuar kostos totale të objekteve, megjithëse vlerat respektive të llogarisë 212 “Ndërtesa dhe konstruksione” dhe llogarisë 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore” janë rritur në kontabilitet, në këto llogari nuk janë shtuar kostot e projekteve përkatëse, në kundërshtim me UMF nr. 8, datë 09.03.2018 “Për paraqitjen e pasqyrave financiare në NjQP”, kapitulli III, pikat 33 e në vijim dhe aneksi I, pika 2 dhe UMF nr. 14, datë 28.12.2006, “Për raportimin e pasqyrave financiare vjetore...”, kapitulli IV.

11/1 Rekomandimi: Nga Bashkia Ura Vajguore, të merren masa nga Nëpunësi Zbatues për të mbajtur të përditësuar regjistrin e aktiveve të njësisë, duke specifikuar në mënyrë analitike secilin aktiv me informacione në lidhje me datën e skadencës, vlerën e shpenzimeve kapitale të mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivitetit, vendndodhjen, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të amortizimit, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes, datën e daljes nga pronësia, etj.

Në vijimësi

12. Gjetje nga auditimi: Llogaria 210 “Toka, troje terrene” gjatë periudhave të audituara (2017, 2018, 2019) e në vijim, ka pasur vlerën 0. Nga ana e Bashkisë Ura Vajguore nuk është bërë vlerësimi dhe regjistrimi në kontabilitet i aktiveve dhe më pas në ZVRPP/Kadastër, në kundërshtim me SKK 5 “Aktivet Afatgjata Materiale dhe Aktivet Afatgjata Jomateriale”. Për zërat e kësaj llogarie nuk është mbajtur regjistër aktivesh sipas përcaktimeve në udhëzimin nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” pikat 26 deri 33. Gjithashtu, nuk ka asnjë dokumentacion të lëvizjes së aktiveve sipas pikave 34 deri 41 të udhëzimit dhe për marrjen në dorëzim të aktiveve të furnizuara dhe inventarizimin e tyre sipas pikave nga 42 deri 94 të këtij udhëzimi.

Llogaria 211 “Pyje, Kullota, Plantacione”, njësoj si për llogarinë 210 “Toka, troje terrene”, janë asete të transferuara me VKM te ish komunat dhe për shkak të mungesës së regjistrimit të aktiveve nuk paraqesin vlerën e vërtetë. Vlera e paraqitur në këtë llogari (3,641,232 lekë për vitin 2017, 4,280,832 lekë për vitin 2018 dhe 4,940,832 lekë për vitin 2019) është e gabuar, pasi nuk paraqet vlerën reale të pyjeve, kullotave dhe plantacioneve, por vlerën e inventarit të pemëve të mbjella në

rrugë, lulishte, parqe, etj., me shtesat dhe pakësimet e veta, e cila duhet të shtohet në llogarinë përkatëse të çdo objekti, si pjesë e të cilit është krijuar.

Për llogarinë 212 “*Ndërtesa e konstruksione*”, për llogarinë 213 “*Rrugë, rrjete, vepra ujore*” dhe për llogarinë 214 “*Instalime teknike, makineri e paisje*”, në asnjë rast vlera e mirëmbajtjes nuk është kontabilizuar dhe nuk janë bërë rivlerësimet e aseteve, si dhe në listat e inventarit nuk janë llogaritur amortizimet, pra mbahen me vlerën historike, veprime që bien në kundërshtim me kërkesat e UMF nr. 8, datë 9.3.2018, kapitulli II, pikat 17 e në vijim dhe kapitulli III, pika 33 e në vijim.

Për llogarinë 215 “*Mjete transporti*”, në fund të vitit 2017 gjendja në bilanc rezulton në vlerën 48,596,898 lekë, në fund të vitit 2018 rezulton në vlerën 40,177,287 lekë dhe në fund të vitit 2019 rezulton në vlerën 32,226,902 lekë. Kjo llogari 215 është mbivlerësuar me zëra të cilët i përkasin llogarisë 214 “*Instalime teknike, makineri e paisje*”. Kjo llogari nuk paraqet vlerën reale dhe është e mbingarkuar në vlerën 33,258,487 lekë.

Nga verifikimi i procedurës për nxjerrjen jashtë përdorimit, u kontaktua se personat e kontraktuar nga bashkia Ura Vajgurore, (G. B. dhe S. N.) nuk janë të pajisur me lejet apo licencat për ushtrimin e profesionit dhe për vlerësimin e mjeteve motorike, pra bien në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 9573, datë 03.07.2006, “*Për auto riparimin, shitblerjen, depozitimin e mjeteve rrugore me motor, të rimorkiove dhe pjesëve të tyre të dala jashtë përdorimit ose të braktisura dhe për veprimtaritë që lidhen me to*” ndryshuar me ligjin nr. 10137/2009”. Nxjerrja jashtë përdorimit e këtij automjeti dhe lëshimi i urdhrave është bërë në kundërshtim me përcaktimet e pikës 5 të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorin publik*. Për sa më sipër, konstatohet se vlera prej 1,378,800 lekë e shkarkuar nga kontabiliteti për nxjerrjen e këtij aktivi jashtë përdorimit, përbën përdorim pa Efikasitet, Ekonomicitet dhe Efektivitet të aktiveve të Bashkisë Ura Vajgurore.

Në llogarinë 231 “*Investime për aktive afatgjata materiale*”, janë përfshirë edhe aktive të cilat kanë përfunduar (pavarësisht se disa nuk janë likuiduar për mungesë fondesh), janë marrë në dorëzim, por nuk ka përfunduar periudha e garancisë. Rrjedhimisht, kjo llogari nuk paraqet vlerën e vërtetë përse i përket aktiveve të cilat janë vënë në përdorim. Mos regjistrimi i vlerave të sakta në këtë llogari, ka sjellë edhe regjistrimin e gabuar në llogarinë 105 të pasivit, “*Teprica e Granteve kapitale te Brendshme*”, ku si rregull regjistrohet vetëm vlera për investimet në proces. Këto veprime bien në kundërshtim me UMF nr. 8, datë 09.03.2018, kapitulli III, pika 31, 33, 36 e në vijim dhe SKK nr. 5 “*Aktivet Afatgjata Materiale dhe Aktivet Afatgjata Jomateriale*”, pika 40. Në urdhrat e inventarizimit dhe vlerësimit të aktiveve, nuk është specifikuar cilat aktive do të inventarizohen dhe vlerësohen dhe si rezultat është realizuar inventarizimi vetëm për llogaritë 214 “*Instalime teknike, makineri, paisje, vegla pune*”, 215 “*Mjete transporti*” dhe 218 “*Inventar ekonomik*”. Janë përjashtuar nga inventarizimi përkatësisht llogaritë 210 “*Toka, troje, terrene*”, 211 “*Pyje dhe Plantacione*”, 212 “*Ndërtesa e Konstruksione*”, 213 “*Rrugë, rrjete e vepra ujore*” dhe Aktivet afatshkurtra, në kundërshtim me pikën 74 të udhëzimit nr. 30 datë 27.12.2011 “*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*. Komisioni i vlerësimit nuk është ngritur në përputhje me pikën 99 të UMF 30, ku përcaktohet se: “*...Kryetar i komisionit të vlerësimit është Nëpunësi Zbatues i njësisë...*”.

Nuk ka një sektor të veçantë apo një zyrë të menaxhimit të aseteve, veprim në kundërshtim me nenin 9 pika f) dhe nenin 8 pika d) të ligjit 10296 datë 08.07.2010 “*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*” dhe pikat 9, 10 11, 13, 14 dhe 21 të VKM-së nr. 500 datë 14.08.2001 “*Për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin e pronave në njësitë e qeverisjes vendore*”.

Në llogaritjen e amortizimit ka diferenca për shkak të mos mbajtjes në rregull të regjistrimit të aktiveve, pasi nuk është e qartë se për cilat aktive është llogaritur amortizimi i shtesave të bëra gjatë vitit, dhe për cilat jo. Llogaritja e gabuar e amortizimit për shkak të mosmbajtjes së regjistrave të aktiveve është në kundërshtim me UMF nr. 30 datë 27.12.2011 “*Për menaxhimin e*

aktiveve në njësitë e sektorit publikë”, si në ekzistencën e një regjistri aktivesh ashtu dhe në dokumentacionin mbështetës për plotësimin e pohimit të ekzistencës së aktivitetit.

Vlera e zërave në pasqyrën e pozicionit financiar 2017, është vendosur bruto nga pasqyrat financiare të njësitë administrative në 2015 dhe nuk është specifikuar në mënyrë analitike, janë bërë shtesat e pakësimet për vitet 2017, 2018 dhe 2019, por në listat e inventarit mbahen me vlerën historike, pa llogaritur amortizimin.

Në regjistrin e inventarit, nuk ka informacion të hollësishëm për përshkrimin e aktivitetit, datën e skadencës, vlerën e shpenzimeve kapitale të mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivitetit, vlerën e akumuluar të amortizimit, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes, datën e daljes nga pronësia, etj.

12/1 Rekomandim: Nga Nëpunësi Autorizues i bashkisë Ura Vajguore, të merren masa për të caktuar Nëpunësin Zbatues të krijojë dhe të mbajë regjistrin e aktiveve të njësisë, duke specifikuar në mënyrë analitike secilin aktiv me informacione në lidhje me datën e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimin e aktivitetit, vlerën e blerjes, datën e daljes në përdorim, datën e skadencës, vlerën e shpenzimeve kapitale të mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivitetit, vendndodhjen, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të amortizimit, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes, datën e daljes nga pronësia, etj. Gjithashtu nga Nëpunësi Autorizues të merren masa për nxjerrjen e urdhrave për krijimin e komisioneve për inventarizimin e menjëhershëm e Aktiveve Afatgjata të pa inventarizuara deri më sot, përkatësisht për zërat: 210 “Toka, troje terrene”, 211 “Pyje, Kullota, Plantacione”, 212 “Ndërtime e konstruksione” dhe 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore.

12/2 Rekomandim: Nga ana e Bashkisë Ura Vajguore të merren masa të menjëhershme që nën strukturën organizative të ngrihet një zyrë apo sektor i veçantë për administrimin e aseteve dhe krijimin e regjistrit të aseteve, e cila të funksionojë vetëm për kohën dhe problematikën e parashikuar. Kjo zyrë apo sektor, të mbajë lidhje të vazhdueshme me zyrën e kadastrës, të përgatitë planimetritë, planvendosjet dhe gjithë dokumentacionin tjetër të nevojshëm, deri në përfundim të regjistrimit dhe kontabilizimit të pronave, si dhe të bëjë përditësimin e vazhdueshëm të regjistrit, duke pasqyruar ndryshimet përkatëse në kontabilitet.

12/3 Rekomandim: Nga ana e Bashkisë Ura Vajguore të merren masa të menjëhershme për nxjerrjen e përgjegjësive për dëmtimin e autoveturës tip V. T., me targë AA...JT, deri në zhdëmtimin e vlerës së saj, si dhe për vlerësimin e aktiveve të mos kontraktohen persona të cilët nuk janë të kualifikuar siç duhet.

12/4 Rekomandim: Nëpunësi Autorizues, të marrë masa që në ngritjen e komisioneve për vlerësimin e aktiveve, kryetar i komisionit të vlerësimit të jetë Nëpunësi Zbatues.

12/5 Rekomandim: Nga Nëpunësi Zbatues, të merren masa për të llogaritur amortizimin në mënyrë progresive dhe për t’i mbajtur në mënyrë kumulative në regjistrin e aktiveve së bashku me të gjitha detajet e tjera të regjistrit, të listuara në rekomandimin 1 më sipër.

Menjëherë

13. Gjetje nga auditimi: Shoqëria Aksionere “Ujësjellës Kanalizime Sha Ura Vajguore” me NIPT K32803022R në ka 100% të aksioneve, në vlerën nominale 170,366,002 lekë, në pronësi 100% të Bashkisë Ura Vajguore. Kjo vlerë nuk paraqitet në llogarinë 26 “Pjesëmarrje në kapitale të veta”, në kundërshtim me UMF nr. 8, datë 09.03.2018, kapitulli III, pika 31.

Alokimi nga Ministria e transportit dhe infrastrukturës i shumës prej 13,100,000 për vitin 2017, si viti i parë i investimit për objektin “Ndërrhyrje emergjente për furnizimin me ujë të Urës Vajguore nga stacioni i pompave Poshnjë, (ndërtim, montime, kolaudim punimesh dhe makineri e pajisje”, me vlerë totale 98,151,828 lekë, është në kundërshtim me përcaktimin në nenin 40 “E drejta për të kryer shpenzime”, të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008, “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në RSH”, i ndryshuar me ligjin nr. 57-2016, datë 02.06.2016. Vlera e alokuar për vitin 2017, duhet të ishte minimalisht 19,630,366 lekë.

Shoqëria “Ujësjetllës Kanalizime Sha Ura Vajguore” është personi i vetëm që ka kompetenca ligjore për furnizimin me ujë të pijshëm për konsumatorët dhe shitjen e ujit në Bashkinë Ura Vajguore, mirëmbajtjen e sistemeve të furnizimit me ujë të pijshëm, etj. Këshilli Bashkiak nuk i ka kaluar fondet e investimeve në ujësjetllës në destinacionin përfundimtar, ku të zhvillohen procedurat e prokurimit, etj., duke vepruar në kundërshtim me Vendimin e Gjykatës me nr. akti 29588, datë 22.04.2003, “Për regjistrimin e personit juridik Ujësjetllës Ura Vajguore SHA”, Aktit të Themelimit dhe Statutit të kësaj shoqërie, Urdhrit të Ministrit të Ekonomisë nr. 73, datë 04.03.2003, “Për transformimin e ndërmarrjes shtetërore “Ujësjetllës Ura Vajguore” Berat në shoqëri anonime”, etj.

Nga ana e bashkisë Ura Vajguore (Këshillit Bashkiak), përveç transferimit të aktiveve, nuk është ndërmarrë asnjë procedurë tjetër, verifikim apo vlerësim i pasurisë dhe fondeve të saj në shoqërinë “Ujësjetllës Kanalizime Sha Ura Vajguore”, përfshirë edhe regjistrimin e aksioneve në llogarinë 26 të pasqyrave financiare të bashkisë, “Pjesëmarrje në kapitalet e veta”.

13/1 Rekomandim: Nga Bashkia Ura Vajguore, nëpërmjet Nëpunësit Zbatues, të merren masa për të bërë sistemimet në kontabilitet dhe regjistrimin e pjesëmarrjes 100% në kapitalin aksionar të “Ujësjetllës Kanalizime Sha Ura Vajguore”, me vlerë kontabël 170,366,002 lekë në llogarinë 26 “Pjesëmarrje në kapitalin e vet”.

13/2 Rekomandim: Nga Bashkia Ura Vajguore, Këshilli Bashkiak, të merren masa që fondet për mallra dhe shërbime të prokurohen nga Shoqëria Aksionare “Ujësjetllës Kanalizime Sha Ura Vajguore”, si i vetmi person juridik përgjegjës me ligj për furnizimin me ujë të popullatës së qytetit Ura Vajguore dhe fshatrave të bashkisë Ura Vajguore.

13/3 Rekomandim: Nga Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës, të merren masa që në angazhimet buxhetore shumëvjeçare, të cilat lidhen me projekte të reja investimesh publike, gjatë vitit të parë të zbatimit të tyre në buxhetin e njësisë përkatëse të qeverisjes të shpërndahen jo më pak se 20 për qind e vlerës së plotë të projektit përkatës.

Menjëherë dhe në vijimësi

14. Gjetje nga auditimi: Llogaria 105 “Teprica e Granteve kapitale të brendshme”

Në fund të vitit 2017 rezulton në vlerën 494,473,628 lekë, në fund të vitit 2018 rezulton në vlerën 584,394,777 lekë dhe në fund të vitit 2019 rezulton në vlerën 548,854,365 lekë.

Nga ana e Bashkisë Ura Vajguore bëhet e ditur se vlerat e paraqitura në bilanc paraqesin investime të përfunduara, të cilat janë marrë në dorëzim dhe aktualisht janë në funksionim, gjë që bie në kundërshtim me UMF nr. 8, datë 09.03.2018 “Për paraqitjen e pasqyrave financiare në NjQP”, aneksi I, pika 2, etj., ku thuhet qartë që duhet të ishin kapitalizuar me fondet bazë kur investimi është marrë në dorëzim. Pra llogaria 105, Teprica e Granteve kapitale të brendshme në këtë rast duhet të ishte me vlerën aktuale, minus vlerën e aktiveve të marra në dorëzim.

14/1 Rekomandim: Nga Bashkia Ura Vajguore, nëpërmjet Nëpunësit Zbatues, të merren masa për të bërë sistemimet në kontabilitet për llogarinë 105 “Teprica e Granteve kapitale të brendshme”.

Menjëherë

15. Gjetje nga auditimi: Nga verifikimi i urdhër shpenzimeve, faturave, procesverbaleve të marrjes në dorëzim, rakordimeve me thesarin, etj., u konstatua se në shumicën e rasteve, urdhrat e shpenzimeve dhe kontratat për prokurime të ndryshme, si me grante/fonde të deleguara, ashtu edhe me fondet e veta, janë bërë pa pasur të disponueshme në llogarinë e institucionit vlerën e plotë të prokurimit, si në rastet e investimeve njëvjeçare, ashtu edhe për investimet shumëvjeçare. Këto veprime dhe mosveprime bien ndesh me dispozitat e përcaktuara në nenin 70 “Lidhja e kontratës”, të VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014. Kjo shkelje ngarkon me përgjegjësi Nëpunësit Autorizues, sipas nenit 71 “Shkelje dhe Sanksione” të Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në R.SH”, ndryshuar me ligjin nr. 114/2012/datë 07.12.2012 dhe ligjin nr. 57/2016, datë 2.6.2016, në pikën b).

15/1 Rekomandim: Nëpunësi Autorizues dhe Nëpunësi Zbatues i bashkisë Ura Vajguore të marrin masa për të mos zhvilluar angazhime shpenzimi për mallra/punë/shërbime, pa pasur paraprakisht në llogarinë e institucionit fondet e nevojshme.

Në vijimësi

15/2 Rekomandim: Bashkia Ura Vajguore (Sektori i Financës), të paraqesë në mbledhjen e Këshillit Bashkiak dhe më pas t'i dërgojë Nëpunësit të parë Autorizues, një material për angazhimet e shpenzimeve për mallra/punë/shërbime të bëra pa pasur fonde në dispozicion.

Në mbledhjen e parë të Këshillit Bashkiak

16. Gjetje nga auditimi: Nga verifikimi i faturimeve të ndryshme, u konstatua se ka pasur mjaft raste (sidomos për kontratat e ndërtimit apo rikonstruksionit) kur faturat janë paraqitur për pagesë pas marrjes në dorëzim të punimeve apo mallrave. Ky veprim apo mosveprim, është në kundërshtim me përcaktimet në ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008 "*Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë*", neni 51, "*Lëshimi i faturës tatimore*", neni 124 "*Kundërvajtjet në lëshimin e faturave tatimore, dëftesave tatimore dhe dokumentimin e transaksioneve*", me ligjin nr. 92/2014 "*Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë*", neni 33 "*Rregulla të veçanta*", neni 99 "*Momenti i lëshimit të faturës*" dhe me UMF nr. 6, datë 30.01.2015 "*Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë*", neni 20 "*Punimet e ndërtimit, kryerja e procesit të ndërtimit, si dhe të mirëmbajtjes*" pika 2 "*Vlera e tatueshme e punimeve të ndërtimit*" dhe pika 3 "*Modalitetet dhe mënyra e zbatimit të TVSH-së në ndërtim*".

Duke mos kërkuar paraqitjen e faturave në momentin e marrjes në dorëzim të punimeve, shërbimeve apo blerjes së mallrave, nga bashkia Ura Vajguore është stimuluar evazioni fiskal, nëpërmjet mospagimit të TVSh-së në momentin e duhur për këto fatura të paraqitura me vonë.

Për marrjen në dorëzim të punimeve, mallrave dhe shërbimeve, në rastet kur faturat janë paraqitur pas marrjes në dorëzim, sipas bazës ligjore të përmendur më sipër, një punë, shërbim apo blerje mallrash quhet e përfunduar në momentin e paraqitjes së faturës, bashkia Ura Vajguore nuk ka proceduar me penalitetet përkatëse sipas kontratave për mos përmbushje të afateve kontraktuale. Për punimet në ndërtim sipas grafikut të kontraktuar për punimet, ditareve dhe situacioneve të punimeve, në rastet kur nuk janë paraqitur situacione, bashkia Ura Vajguore nuk ka proceduar me penalitete për mosrealizimin e grafikut të punimeve, sipas kontratave përkatëse.

16/1 Rekomandim: Bashkia Ura Vajguore të marrë masa për të gjitha subjektet të cilët kanë paraqitur me vonë faturat me TVSH, për të filluar menjëherë llogaritjen e penaliteteve dhe gjobave përkatëse sipas kushteve për mosrealizimin në kohë të kontratave, duke filluar nga data kur punimet/shërbimet apo mallrat duhet të dorëzoheshin sipas kontratës, deri në momentin e paraqitjes së faturës nga furnitori.

16/2 Rekomandim: Bashkia Ura Vajguore (Sektori i Financës), të hartojë një material të detajuar ku të përmbledhen të gjitha rastet e faturave të paraqitura me vonë, përfshirë edhe situacionet për punimet në ndërtim, të cilat nuk janë paraqitur çdo muaj. Ky material të përcillet menjëherë për dijeni në Drejtorinë Tatimore Rajonale Berat ose ku kanë regjistrimin e selisë qendrore subjektet, sipas rastit.

Menjëherë dhe në vijimësi

17. Gjetje nga auditimi: Nga verifikimi i listave të tatimpaguesve në bashkinë Ura Vajguore, u konstatua se pothuajse asnjë nga subjektet të cilët nuk janë me seli qendrore në territorin e bashkisë Ura Vajguore, nuk ka hapur adresë sekondare në bashkinë Ura Vajguore, duke shmangur pagesat e detyrimeve përkatëse tatimore dhe tarifave që zbatohen nga kjo bashki. Rrjedhimisht, këto subjekte kanë bërë shmangien e këtyre pagesave, duke shkaktuar mungesë të ardhurash për bashkinë Ura Vajguore, si dhe duke konkurruar pa të drejtë në tenderat e ndryshëm të zhvilluar nga bashkia Ura Vajguore.

17/1 Rekomandim: Bashkia Ura Vajgurore të marrë masa për të arkëtuar detyrimet tatimore dhe tarifore vendore, nga të gjitha subjektet të cilët kanë operuar në territorin e saj pa licencë/NUIS sekondar, duke llogaritur edhe kamatëvonesat përkatëse. Gjithashtu, të marrë masa që këto subjekte të mos ftohen apo pranohen për të ofertuar në prokurime të ndryshme pa arkëtuar më parë detyrimet në fjalë, të cilat përbëjnë mungesë të ardhurash për buxhetin e bashkisë Ura Vajgurore.

Menjëherë

18.Gjetje nga auditimi:

Nga auditimi i zbatimit të procedurave të prokurimit për vitet objekt auditimi (2017 -2019) nga 43 procedura të zhvilluara me fond limit 642,541 mijë lekë, u audituan 38 prej tyre, me vlerë të fondit limit 625,492 mijë lekë, nga te cilat per investime gjate tre viteve ne vlerën 558,997 mijë lekë, për mallra në vlerën 52,210 mijë lekë dhe shërbime në vlerën 14,285 mijë lekë, konkretisht:

Viti	Numër prokurimesh	Fondi limit	Vlera e kontratës	Audituar	Fondi limit	OE		Diferenca nga F.Limit
						gjithsej	S` kualifikuar	
2017	20	428,815,837	510,727,030	19	426,975,021	36	14	2,706,344
2018	10	79,743,262	4,961,854	10	79,743,262	26	19	2,197,957
2019	13	136,990,119	145,350,994	9	118,773,690	19	8	3,599,707
Shuma	43	642,541,161	737,775,083	38	625,491,973	81	41	8,504,008

Nga auditimi u konstatua se një pjesë e kriterëve të veçanta të DST që lidhen me kapacitetin teknik, nuk janë të lidhura me aftësinë zbatuese dhe llojit të punimeve apo shërbimeve, vlerën dhe natyrën e kontratës, të shërbimeve dhe blerjes së mallrave, si dhe nuk janë argumentuar me procesverbal të veçantë, veprime të cilat kanë çuar në uljen e numrit të pjesëmarrësve, ku në 26 prej procedurave të prokurimit të audituara ose në 68.4% e tyre (43 gjithsej), janë realizuar me pjesëmarrjen nga 1 deri 2 operatorë ekonomik (OE) me vlerë kontrate 460,416 mijë lekë ose 61 %, veprime në kundërshtim me nenet 45, 46 dhe 55 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar VKM nr. 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, neni 61, Kreun X “Shqyrtimi i ankesave”, neni 78 “Ankesat ne autoritetin kontraktor” (trajtuar me hollësisht në faqe 52 -105 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

18.1 Rekomandimi: Titullari i Autoritetit Kontraktor Bashkia Ura Vajgurore, për çdo rast të procedurave të zhvilluara të ngrejë një grup pune me specialist të fushës (sipas llojit të procedurës), për hartimin e specifikimeve teknik dhe kriterëve sipas llojit të procedurës, duke dhënë argumente të lidhura ngushtë me objektin e prokurimit, për secilin kriter me procesverbal, i cili të bëhet pjesë e dosjes së procedurës.

B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI:

Bazuar në ligjin nr. 154, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” neni 15 shkronja (b) dhe (c) -Të drejtat e KLSH, dhe mbështetur në nenet 98-102, të ligjit nr. 44, datë 30/4/2015 “Kodi i procedurave administrative në Republikën e Shqipërisë”, nenet 21-33, të ligjit nr. 139, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, dhe pikën 93 të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 ”Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, nga ana e Titullarit të njësisë publike (Bashkia Ura Vajgurore), të nxirren aktet administrative përkatëse dhe të kërkohet në rrugë ligjore (Padi Gjyqësore), duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit. Nëpunësi zbatues të ndjekë procesin me qëllim shpërblimin e dëmit në vlerën **42,161,450 lekë**, si më poshtë:

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt: - **“Rikonstruksione rrugësh në Bashkinë Ura Vajgurore”, të zhvilluar në vitin 2017**, me vlerë të kontratës (me Tvsh) 150,008,367.60 lekë, fituar nga BOE fitues “L. K.” & “T.” Shpk, rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në fakt në vlerën **585,703 lekë pa Tvsh**. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 1541/12 prot., datë 18.09.2017. *(trajtuar më hollësisht në faqet 105 -125 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*.

1.1. Rekomandim: Nga Bashkia Ura Vajgurore të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **585,703 lekë pa Tvsh** nga BOE fitues “L. K.” & “T.” Shpk, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 1541/12 prot., datë 18.09.2017, me objekt: “Rikonstruksione rrugësh në Bashkinë Ura Vajgurore”, Bashkia Ura Vajgurore, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

Menjëherë

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt: - **“Rikonstruksion i shkollës së mesme të bashkuar Refat Bani”,**, me vlerë të kontratës (me Tvsh) **62,781,144** lekë, fituar nga BOE fitues “T.” & “F.” & “B. B.” Shpk, rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në fakt në vlerën **393,570** lekë pa Tvsh. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 1296/13 prot., datë 11.08.2017 *(trajtuar më hollësisht në faqet 105 -125 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*.

2.1. Rekomandim: Nga Bashkia Ura Vajgurore të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **393,570 lekë pa Tvsh** nga BOE fitues “T.”&”F.”&” B. B.” Shpk në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 1296/13 prot., datë 11.08.2018, me objekt: “Rikonstruksion i shkollës së mesme të bashkuar Refat Bani”, Bashkia Ura Vajgurore, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

Menjëherë

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt: **“Sistemim varrezash dhe rrugët hyrëse në Bashkinë Ura Vajgurore**, me vlerë të kontratës (me Tvsh) 35,165,454 lekë, fituar nga BOE “K.” & “T.” Shpk, rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në fakt në vlerën **304,391 lekë pa Tvsh**. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 1288/13 prot., datë 11.08.2017, *(trajtuar më hollësisht në faqet 105 -125 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*.

3.1. Rekomandim: Nga Bashkia Ura Vajgurore të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **304,391 lekë pa Tvsh** nga BOE “K.” & “T.” Shpk,, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 1288/13 prot., datë 11.08.2017,, me objekt: **“Sistemim varrezash dhe rrugët hyrëse në Bashkinë Ura Vajgurore”,** Bashkia Ura Vajgurore, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

Menjëherë

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt: **“Rikualifikimi urban dhe krijimi i ambjentëve të Rekreacionit në fshatin Donofrosë”,** Bashkia Ura Vajgurore, me vlerë të kontratës (me Tvsh) 9,477,624 lekë, fituar nga “R. C.” Shpk, rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në fakt në vlerën **100,000 lekë pa Tvsh**. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 1215/19 prot., datë 10.07.2018, *(trajtuar më hollësisht në faqet 105 -125 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*.

4.1. Rekomandim: Nga Bashkia Ura Vajgurore të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **100,000 lekë pa Tvsh** nga OE “R. C.” Shpk, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 1215/19 prot., datë 10.07.2018, me objekt: “Rehabilitim rruga Pllakë Kulluricë”, Bashkia Ura

Vajgurore, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

Menjëherë

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt: **“Rikualifikimi urban dhe krijimi i ambjentëve të Rekreacionit në fshatin Samaticë”**, Bashkia Ura Vajgurore, me vlerë të kontratës (me Tvsh) 7,999,092 lekë, fituar nga BOE “T.” & “E. K. Shpk, rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në fakt në vlerën 100,000 lekë pa Tvsh. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 2420/16 prot., datë 15.11.2018 (trajtuar më hollësisht në faqet 105 -125 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

5.1. Rekomandim: Nga Bashkia Ura Vajgurore të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **100,000 lekë pa Tvsh** nga BOE “T.” & “E. K. Shpk, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 2420/16 prot., datë 15.11.2018, me objekt: **“Rikualifikimi urban dhe krijimi i ambjentëve të Rekreacionit në fshatin Samaticë”** Bashkia Ura Vajgurore, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

Menjëherë

6. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt **“Sistemim i rrugës së tregjeve (Loti 1)”**, Bashkia Ura Vajgurore, me vlerë të kontratës (me tvsh) 70,906,936 lekë, fituar nga OE “S.” SHPK, rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në fakt në zërat “Beton C16/20 për kunetë”, “Puseta betoni me kapak gize 40 x 40 cm, çmimi”, “Shtresë çakull gurore për bankinat t=10 cm”, “Shtresë çakull gurore për bankinat t=10 cm” etj., në vlerën **1,593,206 lekë pa tvsh**. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 983/1 Prot, datë 18.04.2017 (trajtuar më hollësisht në faqet 105 -125 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

6.1. Rekomandim: Nga Bashkia Ura Vajgurore të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **1,593,206 lekë pa tvsh** nga OE “S.” SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 983/1 Prot, datë 18.04.2017, me objekt “Sistemim i rrugës së tregjeve (Loti 1)”, Bashkia Ura Vajgurore, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

Menjëherë

7. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt **“Kanali ujitës BRU – 15 Manastir dhe ushqyesi i rezervuarit”**, Bashkia Ura Vajgurore, me vlerë të kontratës (me tvsh) 22,659,480 lekë, fituar nga BOE “F.” & “Sh.” SHPK, rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në fakt në zërin “Ndërtim mur gabioni me rrjet xingato”, në vlerën 326,000 lekë pa tvsh. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve me nr. 1130/11 prot datë 05.07.2017 (trajtuar më hollësisht në faqet 105 -125 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

7.1. Rekomandim: Nga Bashkia Ura Vajgurore të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **326,000 lekë pa tvsh** nga BOE “F.” & “Sh.” SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 1130/11 prot datë 05.07.2017, me objekt “Kanali ujitës BRU – 15 Manastir dhe ushqyesi i rezervuarit”, Bashkia Ura Vajgurore, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

Menjëherë

8. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi rezulton se:

- në procedurën me objekt “Blerje Autoveture” të zhvilluar vitin 2018, me fond limit 2,750,000 lekë, shpallur fitues OE “O.” shpk, rezultoi se nga veprimet dhe mosveprimet e KVO-së nuk

përputhen me kërkesat e kuadrit rregullator në fuqi mbi prokurimet publike dhe kanë shkaktuar dëm ekonomik të paarkëtueshëm prej 150,000 lekë;

- në procedurën e prokurimit “Mirëmbajtje dhe riparim automjetesh” të zhvilluar në vitin 2018, me fond limit 1,463,300 lekë shpallur fitues OE “P. I.” shpk për mos anulimin e procedurës dhe shpalljen e fituesit i cili nuk i plotëson kriteret e DST, veprimet dhe mosveprimet e KVO-së nuk përputhen me kërkesat e kuadrit rregullator në fuqi mbi prokurimet publike kanë shkaktuar dëm ekonomik të paarkëtueshëm në vlerën 311,760 lekë;

- në procedurën e prokurimit “Ndërtim dhe mirëmbajtje urash” të zhvilluar në vitin 2018, me fond limit 3,441,494 lekë shpallur fitues OE T. shpk nga veprimet dhe mosveprimet e KVO-së nuk përputhen me kërkesat e kuadrit rregullator në fuqi mbi prokurimet publike dhe kanë shkaktuar dëm ekonomik të paarkëtueshëm prej 443,820 lekë.

- në procedurën e prokurimit “Hartim projekt preventiv për rikonstruksionin e Qendrës Kulturore Bashkia Ura Vajgurore”, me fond limit 4,230,790 lekë të zhvilluar në vitin 2017, fituar nga BOE “E. G.” shpk & “A. S.” rezultoi se nga veprimet dhe mosveprimet e KVO-së nuk përputhen me kërkesat e kuadrit rregullator në fuqi mbi prokurimet publike dhe kanë shkaktuar dëm ekonomik të paarkëtueshëm prej 1,201,000 lekë.

Trajtuar më hollësisht në faqet 52 -105 të Raportit Përfundimtar të auditimit

8/1 Rekomandimi: Nga ana e Titullarit të Autoritetit Kontraktor, Bashkia Ura Vajgurore, në lidhje me procedurat e prokurimit të sipërcituara, për veprimet dhe mosveprimet e anëtarëve të KVO-së, të trajtuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit të KLSH-së, të vlerësohet shkalla e përgjegjësisë për çdo punonjës të atakuar dhe marrjen e masave disiplinore.

9. Gjetje nga auditimi: Në Bashkinë Ura Vajgurore ushtrojnë aktivitete për shfrytëzimin e sipërfaqeve pyjore/kullosore 17 subjekte për sipërfaqe 35 ha, është lidhur 1 kontratë qiraje, për sipërfaqe 16.2 ha. Për këto sipërfaqe nga Sektori i Pyjeve dhe Mbrojtjes Mjedisit, nuk janë zbatuar procedurat e pakësimit të sipërfaqes së fondit pyjor/kullosor, siç përcaktohet në nenin 17, të ligjit nr. 9385, datë 04.05.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, i ndryshuar, pika 6 e nenit 17, të ligjit nr. 9693 datë 19.03.2007 “Për Fondin kullosor”, pikat 3, 7, 9,10,11 dhe 12, të VKM nr. 1353, datë 10.10.2008 “Për rregullat për paraqitjen e kërkesës, mbajtjen dhe plotësimin e dokumentacionit teknik, kriteret dhe procedurat e zvogëlimit të sipërfaqes dhe të vëllimit të fondit pyjor”, i ndryshuar me VKM nr. 435, datë 08.06.2015, si dhe pikat 3, 6, 7, 9 dhe 11, të VKM nr. 1354, datë 10.10. 2008 “Për rregullat dhe procedurat që ndiqen për heqjen, shtimin dhe ndryshimin e destinacionit të fondit kullosor” për të cilat nga mos lidhja e kontratave të qirave për të ardhurat e munguara është shkaktuar dëm ekonomik për buxhetin e Bashkisë në shumën **36,652,000 lekë** (trajtuar me hollësisht në faqe 21 -37 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

9/1 Rekomandimi: Drejtoria e të Ardhurave Vendore Bashkia Ura Vajgurore, të marrë masa për të kontabilizuar detyrimin dhe të kërkojë në rrugë ligjore arkëtimin e vlerës prej **36,652,000 lekë**, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera ligjore në të gjitha shkallët e gjykimit ndaj debitorëve, duke e konsideruar respektivisht këtë mospagesë si dëm ekonomik që duhet të arkëtohet.

Menjëherë

B/I. MASA PËR ELEMENIMIN E PALIGJSHMËRIVE NË TRAJTIMIN E SUBJEKTEVE LIDHUR ME LLOGARITJEN E DETYRIMEVE PËR TAKSAT DHE TARIFAT VENDORE ME EFEKTE NË TË ARDHURAT E MUNGUARA NË BASHKINË URA VAJGURORE.

Bazuar në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” neni 15 shkronja (b) dhe (c) –*Të drejtat e KLSH* dhe mbështetur në nenet 98-102, të ligjit nr. 44/2015, datë 30.4.2015 “Kodi i procedurave administrative në Republikën e

Shqipërisë”, nenet 21-33, të ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” dhe pikën 93, të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 ”Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, nga Kryetari i Bashkisë Ura Vajguore, të nxirren aktet administrative përkatëse dhe të kërkohet në rrugë ligjore (Padi Gjyqësore), duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim kërkimin e të ardhurave të munguara në **shumën 223,114,696 lekë, si më poshtë vijon:**

1- Gjetje nga auditimi: Nga të dhënat rezultojnë se për vitin 2019: nuk kanë paguar taksën e tokës me tarifën përkatëse, 7,531 familje në shumën **166,711,179 lekë**, taksa lokale me tarifën përkatëse, 909 familje në shumën **9,010,940 lekë**, si dhe 210 familje për qiranë e tokës bujqësore në vlerën **12,228,661 lekë** të cilët rezultojnë debitorë me datë 31.12.2019. Për vitin 2019, nuk kanë paguar taksë ndërtesë, pastrimi, ndriçimi e gjelbërimi 5439 familje në shumën **13,001,000 lekë**, të cilët rezultojnë debitorë me datë 31.12.2019.

Në Bashkinë Ura Vajguore nga subjekte të biznesit të vogël dhe të madh për të cilat janë planifikuar të ardhura për taksa e tarifa vendore pavarësisht punës së bërë niveli i arkëtimit është shumë i ulët. Kështu nga 21,749,029 lekë për vitet objekt auditimi janë arkëtuar vetëm 37.7% kanë mbetur pa u arkëtuar **13,542,916 lekë**.

Nga auditimi vjeljes së gjobave të vendosura nga Inspektorati i Mbrojtjes Territorit Vendor për periudhën deri 31.12.2019 rezultoi se janë pa arkëtuar **2,020,000 lekë**.

Veprimet sa më sipër janë në kundërshtim me ligjin nr.9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, për subjektet debitorë, vijon me procedurat e arkëtimit të detyrimeve në zbatim të kreut XI-“Mbledhja me forcë e detyrimeve tatimore të papaguara” (trajtuar me hollësisht në faqe 21 -37 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

1/1 Rekomandimi: Drejtoria e Financës në bashkëpunim me Zyrën Juridike, Drejtorinë e të Ardhurave Vendore dhe Drejtoria e Shërbimit Pyjor, të marrin masa duke ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore për arkëtimin e :

- taksës së tokës me tarifën përkatëse, në shumën **166,711,179 lekë**,
- taksës lokale me tarifën përkatëse, në shumën **9,010,940 lekë**,
- qiranë e tokës bujqësore në vlerën **12,228,661 lekë**
- taksës së ndërtesës, pastrimit, ndriçimit e gjelbërimit në shumën **13,001,000 lekë**, të cilët rezultojnë debitorë me datë 31.12.2019.
- taksës e tarifës vendore nga subjekte të biznesit të vogël dhe të madh në shumën **13,542,916 lekë**.
- gjobave të vendosura nga Inspektorati i Mbrojtjes Territorit Vendor për periudhën deri 31.12.2019 rezultoi se janë pa arkëtuar **2,020,000 lekë**.

Menjëherë

2.Gjetje nga auditimi: Gjatë auditimit të taksave/ tarifave vendore për subjektet që tregtojnë hidrokarbure dhe derivatet e tyre, u konstatua se ka mangësi në plotësimin e të dhënave të këtyre subjekteve në përgjithësi dhe debitorëve në veçanti.

Nga auditimi i kësaj kategorie të bizneseve, në lidhje me pajisjen me lejet përkatëse të tregtimit dhe pagesat e tyre (autorizimeve), u konstatua se nuk është aplikuar saktë tarifa për pajisjen me leje tregtimi për karburantet.

Detyrimet për pajisjen me licence tregtimi nuk janë paguar në përputhje me bazën ligjore të sipërpërmendur, sipas të cilës këto subjekte duhet të paguajnë 1,000,000 lekë për stacionet e shitjes së karburanteve, gazit të lëngshëm, të naftës për automjetet dhe vajrat lubrifikante, duke mos aplikuar dhe arkëtuar vlerën prej **4,600,000 lekë**, si e ardhur e munguar.

Gjithashtu dy subjekte që kanë filluar aktivitetin e tyre dhe janë mbyllur më vonë nga përmbarimi apo pezulluar nga QKB, nuk kanë paguar detyrimin përkatës me nga 1,000,000 lekë, në total **2,000,000 lekë**. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Neni 35, të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore”, i ndryshuar. VKM nr.170, datë

25.4.2002 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e lejeve të autorizimeve për tregtimin e naftës, gazit e nënprodukteve të tyre”, i ndryshuar, VKM nr. 970, datë 2.12.2015 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj”, i ndryshuar

(trajtuar me hollësisht në faqe 21 -37 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

2.1 Rekomandimi Drejtoria e të Ardhurave Vendore Bashkia Ura Vajguore, të marrë masa për të kontabilizuar detyrimin dhe të kërkojë në rrugë ligjore arkëtimin e vlerës prej **6,600,000 lekë**, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera ligjore në të gjitha shkallët e gjykimit ndaj debitorëve

Menjëherë

B/II. MASA PËR ULJEN E BORXHIT TATIMOR DUKE RITUR PERFORMANCËN NË ARKËTIMIN E DETYRIMEVE PËR TATIM TAKSAT VENDORE.

1. Gjetje nga auditimi: Nga të dhënat rezultojnë se për vitin 2019:

Nga auditimi i të dhënave të Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore, rezultojnë se më datën 31.12.2019, për mos pagesën e detyrimeve tatimore janë debitorë **95 subjekte të biznesit të vogël, 23 të biznesit të madh, të cilët nga të dhënat e zyrës së financës janë kontabilizuar, në vlerën prej 23,615,358 lekë.**

Në vlerën e mësipërme për periudhën objekt auditimi, përfshihen debitorët e biznesit të vogël për subjekte në vlerën 4,740,225 lekë, (NJA Ura Vajguore, për 19 subjekte në vlerën 1,098,625 lekë, NJA Kutalli 69 për subjekte në vlerën 3,331,276 lekë, NJA Poshnjë për 4 subjekte në vlerën 155,854 lekë, NJA Cukalat për 3 subjekte në vlerën 154,470 lekë).

Në vlerën e mësipërme është përfshirë dhe shuma e vlerës debitorë për subjekte të Njësisë Administrative Kutalli të lënë nga KLSH me procesverbalin nr. 18 datë 12.05.2017, për subjekte 28 biznes i vogël me vlerë 1,060,440 lekë sipas Aneksit B/1,2,3.

Debitorët e biznesit të madh për 23 subjekte në vlerën 18,875,133 lekë, (NJA Ura Vajguore, për 18 subjekte në vlerën 18,481,544 lekë, NJA Kutalli për 2 subjekte në vlerën 116,291 lekë, NJA Poshnjë 3 për subjekte në vlerën 277,298 lekë). Në vlerën e mësipërme është përfshirë dhe shuma e vlerës debitorë për 3 subjekte të NJA Ura Vajguore, të lënë nga KLSH me procesverbal nr.18 datë 12.05.2017, për 3 subjekte biznes i madh me vlerë 7,490,440 lekë.

(trajtuar me hollësisht në faqe 21 -37 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

1/1 Rekomandimi: Drejtoria e Tatim Taksave në Bashkinë Ura Vajguore të merren masa, për arkëtimin e detyrimeve tatimore dhe të bëhen njoftim vlerësimet tatimore, për 118 subjekte debitorë në shumën **23,615,358 lekë**, bazuar në nenin 70 pika 3 të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në RSH”, i ndryshuar, duke ndjekur rrugët e mëposhtme:

a - Tu dërgohen bankave urdhra bllokimi për llogaritë bankare, bazuar në nenin 90, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

b - Të dërgojnë Drejtorinë Rajonale të Transportit, kërkesa për vendosjen e barrës siguroese (për mjetet) dhe në Zyrën Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, bazuar në nenin 91, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

c - Për subjektet të cilët nuk paguajnë detyrimet tatimore në afat, të llogaritet kamat vonesa (gjobë në masën 0,06 % kamat vonesë të detyrimit në ditë por jo më tepër se 365 ditë), bazuar në nenin 114, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

d-Në rast se bizneset private edhe pas njoftimeve zyrtare dhe dërgimit të urdhër bllokimeve në bankë nuk kryejnë pagesën e detyrimeve, bazuar në nenin 182, të ligjit të Kodit Penal në RSH i ndryshuar, pasi të vendosen masa administrative të bëhet kallëzim penal.

Drejtoria e Tatim Taksave në Bashkinë Ura Vajgurore, të listohen në mënyrë elektronike abonentët familjarë dhe të merren masa për arkëtimin e taksave të tokës për vlerën 187 951 380 lekë, të ndarë si më poshtë:

- I. Njësia Administrative Urë Vajgurore - Për 923 abonentë për taksa toke dhe tarifa lokale në vlerën 15 894 282 lekë 2.909 abonentë për taksa dhe tarifa lokale në vlerën 9 010 940 lekë
- II. Njësia Administrative Kutalli- 1.2906 abonentë për taksa toke dhe tarifa lokale në vlerën 67 889 981 lekë 2.208 abonentë për qiranë e tokës bujqësore, në vlerën 12 183 538 lekë
- III. Njësia Administrative Poshnjë -1.2597 abonentë për taksa toke dhe tarifa lokale, në vlerën prej 63 479 466 lekë
- IV. Njësia Administrative Cukalat -1.1105 abonentë për taksa toke dhe tarifa lokale, në vlerën prej 19 448 050 lekë

2.2 tatimpagues debitorë për qiranë e tokës bujqësore, në vlerën 45 123 lekë

a- Në zbatim të pikës 71, të udhëzimit plotësues të Ministrisë Financave nr. 01, datë 15.01.2016 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2018”, sipas të dhënave që disponon Gjendja Civile, të njoftohen tatimpaguesit familjarë me njoftim vlerësimi tatimor edhe në median lokale të Bashkisë për të paguar detyrimin tatimor. Njoftim Vlerësimet t’ju dërgohen nëpërmjet Zyrës Postare, për të gjitha llojet dhe shumën e taksave të papaguara, si taksën e tokës, ndërtesës dhe tarifën të tjera të paguara.

Menjëherë

B/III. MASA PËR ELIMINIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCE DHE EFEKTIVITET (3E), TË FONDEVE PUBLIKE

1.Gjetje nga auditimi. Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile, të kontratës me objekt “*Rikualifikimi urban dhe krijimi i ambienteve të Rekreacionit në fshatin Donofrose*”, me vlerë të kontratës 9,477,624 lekë, fituar nga OE “R. C.” SHPK, rezulton që punimet, sipas njoftimeve përkatëse punimet kanë përfunduar në datë 19.08.2018. Nga auditimi i realizimit të punimeve në objekt, u konstatua se mungonin fidanë, lodra, ulëse, shtylla ndriçimi, etj., në vlerën 625,300 lekë pa Tvsh, për të cilat pretendohet se me marrjen në dorëzim të punimeve kanë qenë të vendosura në objekt. Me vënien në funksionim të objektit (me marrjen në dorëzim të punimeve) gjatë funksionimit të këtij parku, ka rezultuar neglizhencë nga ana e Autoritetit Kontraktor në verifikimin e gjendjes dhe marrjen e masave të nevojshme për dokumentimin, mbrojtjen, qarkullimin dhe nxjerrjen nga përdorimi të aktiveve, me qëllim menaxhimin me efektivitet dhe ruajtjen e tyre nga dëmtimi dhe keqpërdorimi.

(trajtuar me hollësisht në faqe 105 -125 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

1.1. Rekomandimi: Bashkia Ura Vajgurore të dokumentojë keqpërdorimin e aktiveve, evidentimin e përgjegjësive si dhe rikuperimin e objekteve të dëmtuara në vlerën prej 625,300 lekë pa Tvsh, e cila përfaqëson vlerën e zërave të punimeve të realizuara nga kontraktori “R. C.” Shpk, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 1215/19 Prot datë 10.07.2018 me objekt “*Rikualifikimi urban dhe krijimi i ambienteve të Rekreacionit në fshatin Donofrose*”, për të cilën është shkaktuar efekt ekonomik negativ buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si rrjedhojë e dëmtimit të punimeve të kryera dhe të dëmtuara.

Menjëherë

B/IV. MASA PËR ELIMINIMIN E PALIGJSHMËRISË TË PËRDORIMIT TE FONDEVE PUBLIKE NË PROCEDURAT E PROKURIMIT PUBLIK.

1. Gjetje nga auditimi: Referuar të dhënave të regjistrit të realizimit të prokurimeve për periudhën 01.01.2017 – 31.12.2019, u konstatua se nga **43** procedura prokurimi të vlerësuara për

auditim me fond limit **642,541 mijë lekë**, janë konstatuar me shkelje të akteve ligjore/nënligjore të LPP në **19** procedura me fond limit **369,275 mijë lekë** ose 57.5 % e vlerës së fondit limit të audituar, veprime në paligjshmëri të përdorimit të fondeve në vlerën **342,865 mijë lekë**, veprime në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 1 “Objekti dhe qëllimi” pika 2, shkronja (a), (b), (d) dhe (dh), neni 2 “Parimet e përzgjedhjes” shkronja (a), (b) dhe (c), dhe me nenet 46 dhe 55, si dhe neni 73 i VKM nr. 797, datë 29.12.2017 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 914, datë 29.12.2014, të këshillit të ministrave,” për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar (trajtuar me hollësisht në faqe 52 -105 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

1.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Ura Vajgurore, të analizojë dhe nxjerrë përgjegjësitë për kualifikimin e ofertave ekonomike të cilat nuk plotësojnë kriteret e kërkesave kualifikuese të DST, me pasojë përdorimi me paligjshmëri i fondeve publike për vlerën **342,865 mijë lekë** pa TVSH. Të konsiderojë faktin se kualifikimi i operatorëve ekonomik të cilët nuk plotësojnë kriteret e DST, përveçse është shkelje e kuadrit rregullator në fuqi, por edhe risk real për shpenzimet e njësisë publike, pasi këta operatorë për shkak të mangësive nuk japin siguri për kryerjen me sukses dhe cilësi të kushteve të kontratës

Menjëherë dhe në vijimësi

D. MASA DISIPLINORE:

Për punonjësit që janë pjesë e shërbimit civil dhe me kontratë pune.

Mbështetur në nenin 15, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”; geramat (b, c, ç) e nenin 58-“Llojet e masave disiplinore”, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”; VKM nr. 115, datë 05.03.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil”; neni 37 të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1996 “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë”; shkronja (b) e nenit 9- “Masa disiplinore”, të kontratës individuale, dhe shkronja (k) e nenit 64, të ligjit nr. 139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, **i rekomandojmë Kryetarit të Bashkisë Ura Vajgurore që t’i kërkojë Komisionit Disiplinor, pranë Institucionit Tuaj, që bazuar në performancën e secilit punonjës dhe të shkeljeve të konstatuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit të KLSH-së, të vlerësojë shkallën e përgjegjësisë për çdo punonjës të atakuar dhe marrjen e masave disiplinore përkatëse.**

Menjëherë

E. MASA ADMINISTRATIVE

E.1 Referuar shkeljeve të konstatuara në fushën e ndërtimit, përcaktuar në nenit 7 dhe 12 i ndryshuar, Kreu III, nenet 15 e 16 të ligjit nr. 8402, datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar dhe Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, Kreu II, Pika 3, bazuar në nenin 15 dhe nenin 30, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014, “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, **i rekomandojmë, Kryetarit të Bashkisë Ura Vajgurore t’i kërkojë Kryeinspektorit të Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit Vendor, të vlerësojë shkeljet e konstatuara dhe të vendosë masë administrative (gjobë) për një mbikëqyrës, si më poshtë:**

1. **50,000 lekë për B. S.**, në cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve me kontratën nr. 983/1 Prot, datë 18.04.2017, për shkeljet e konstatuara në objektin “*Sistemim i rrugës së tregjeve (Loti I)*”, *Bashkia Ura Vajguore*, me sipërmarrës punimesh OE “S.” SHPK, me pasojë dëm ekonomik në vlerën 1,593,206 lekë pa tvsh, si rrjedhojë e diferencave në volume pune të likuiduara por të pakryera në fakt.

Menjëherë

F. SHËNIM I DREJTORIT TË DEPARATMENTIT TË AUDITIMIT TË NJËSIVE TË VETËQEVERISJES VENDORE DHE GRUPIT TË AUDITIMIT.

Gjatë auditimit të zbatimit të kontratës të lidhur në dhjetor 2016, midis Autoritetit Kontraktor Bashkia Ura Vajguore dhe sipërmarrësve “E. K.” shpk & “S.” shpk, me objekt “Shërbimi i pastrimit në Bashkinë Ura Vajguore”, u paraqit shkresa e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë, Berat, nr. Prot., 4214/6, datë 14.04.2020, e protokolluar në KLSH me nr. 369, datë 16.04.2020, sipas së cilës u kërkua vënia në dispozicion e dokumenteve të marra nga grupi i KLSH për auditim. Nga ana e grupit të auditimit u dorëzua dokumentacioni në protokollin e Bashkisë Ura Vajguore me numër protokolli 1072, datë 20.04.2020 dhe auditimi për këtë çështje nuk është kryer.

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Vetëqeverisjes Vendore.

Bujar LESKAJ

K R Y E T A R